

RAPORT INDIVIDUAL I KONSULTIMIT PUBLIK

1. Titulli i projektaktit

Projektvendimi “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tregut të produkteve të peshkimit dhe akuakulturës dhe për miratimin e formës dhe përmbajtjes së planeve të prodhimit dhe marketingut”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Procesi i konsultimit publik nëpërmjet RENJKP ka zgjatur nga data 15.1.2026 deri më 12.2.2026, njëzetë (20) ditë të plota pune, proces gjatë të cilit nuk pati komente apo sugjerime lidhur me projektvendimin.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektvendimin “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tregut të produkteve të peshkimit dhe akuakulturës dhe për miratimin e formës dhe përmbajtjes së planeve të prodhimit dhe marketingut”, ishin:

- Konsultimi elektronik përmes Regjistrisë Elektronike, RENJK (15.1.2026 - 12.2.2026).
- Marrja e mendimeve nga ministritë e linjës dhe institucionet e tjera, si proces bashkrendimi i projektvendimit nëpërmjet sistemit e-akte dhe komunikimeve elektronike (tetor 2025 - prill 2026).

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Projektvendimi u hartua nga një grup pune, i ngritur me urdhër të Ministrit nr. 371, datë 14.4.2025, i përbërë nga përfaqësues të MBZHR-së.

Nuk ka patur palë interesi jo qeveritar, për hartimin dhe konsultimin e projektaktit.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Nga procesi i konsultimit të projektvendimit ka patur 215 shikime në RENJKP, por nuk ka patur komente.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
---	--	---	---	-------------